

EDMOND MALAJ

## MONUMENTET KISHTARE TË DRISHTIT NË MESJETË

Drishti kishte shumë kisha edhe kapela<sup>1</sup> dhe nga Shufflaj cilësohet si një ndër fidanishtet më të mëdha të klerit katolik shqiptar, krahas Shasit (*Saucium*).<sup>2</sup> Kishat e Drishtit ishin me mure të trasha<sup>3</sup> dhe deri më sot dimë se ky qytet kishte këto katedrale dhe kisha, disa prej të cilave përmenden edhe në dokumentet raguzanë dhe venedikase: katedralja e Shën Gjergjit, katedralja e Shën Mërisë me Kapitull (*1353 capitulum ecclesie S. Marie de Drivasto*), kisha e Shën Françeskut (1353, 1368) dhe kisha e Shën Shelbuemit (*S. Salvator 1399*),<sup>4</sup> kisha e Shën Kryqit, kisha e *Sancta Maria Veteris*, kisha e Shën Stefanit, kisha e Shën Prendës dhe kisha e Shën Kollit. Le të shohim disa të dhëna më të zgjeruara në lidhje me këto kisha.

---

<sup>1</sup> “*Quoniam consuevimus ire cum procesione ad capellas quas habemus, statuimus ut is, cui mandatit rector, vadat cum procesione.*” Statutet dhe Urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit (*Statuta et Ordinationes Capituli Ecclesiae Cathedralis Drivastensis*), përgatitur për botim dhe përkthyer nga dr. Musa Ahmeti dhe dr. Etleva Lala, Tiranë: OMBRA GVG 2009, Capitulum XIII, f. 151. (Në vijim cituar si: *Statuta et Ordinationes*, Capit. nr.)

<sup>2</sup> *Po aty*, f. 48.

<sup>3</sup> Oliver Jens Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392-1479)*, München: Oldenburg 2001 (Südosteuropäische Arbeiten 110. Für Südost-Institut München Hrsg. v. Edgar Hösch und Karl Nehring.), f. 99 (Në vijim cituar si: O. Schmitt, *Das venezianische Albanien*, f.)

<sup>4</sup> Milan von Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchzone im katholischen Damme”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 188-262. (Cituar si: M. Šufflay, “Kirchenzustände”, në: *Forschungen I*, f.)

### **Kishat e dokumentuara, brenda qytetit**

*Katedralja e Shën Mërisë me Kapitull* (përmendur në vitin 1352) (*capitulum ecclesiae S. Mariae de Drivasto 1352*), kishte edhe një shkollë.<sup>5</sup> Me “shkollë” bëhet fjalë këtu për vëllazëritë (lat. *confraternitas*) që ekzistonin në Mesjetë afër kishave. Madje kulti i Shën Mërisë ishte aq shumë i rëndësishëm, sa që ikona e Shën Mërisë ndodhej edhe në monedhat e këtij qyteti. Duket se kjo kishë pësoi një shkatërrim dhe u boshatis gjatë vitit 1241, kohë kjo kur qyteti u sulmua nga mongolët.<sup>6</sup> Kapitulli i Drishtit ishte i ndarë në kolegje; në vitin 1400 përmenden këtu “kanonikët e Shën Mërisë” (*canonisi de sancta Maria*) dhe “kanonikët e Shën Gjergjit” (*canonisi de san Zorzi*).<sup>7</sup> Ata organizoheshin sipas “Statuteve të Kapitullit të Katedrales”.

Mesa duket të gjithë këta banonin në një kanonikë të përbashkët (*canonica*)<sup>8</sup> apo shtëpi kanonikale (*domo canonicali*), siç thuhet në një dokument gjoja të vitit 1295<sup>9</sup>. Dokumenti i vitit 1295, që si datë i përket gjysmës së dytë të shek. XIII (1261-1282, apo 1295) është më saktë një diplomë e perandorit Mihael Paleologu, i cili gjoja me anë të saj, Mihael Engjëllit (Mihael Angelos) dhe birit të tij Andrea Engjëllit, si princër të qytetit që ishin, u konfirmon edhe një herë privilegje, të cilat ua kishte njohur edhe Leoni I stërgjyshërve të tyre, të cilët gjoja kishin themeluar qoftë qytetin qoftë kishën katedrale së bashku me shtëpinë kanonikale me anë të pasurisë së tyre.<sup>10</sup>

<sup>5</sup> “[...] ut nostra ecclesia cathedralis et ecclesia S. Georgii et tres scole maiores videlicet S. Crucis, S. Georgii, S. Marie sint exemptae ab onere decimarum prout antea fuerunt.” *Statuta et Ordinationes*, f. 55.

<sup>6</sup> *Po aty*, f. 43.

<sup>7</sup> M. Šufflay, “Kirchenzustände”, në: *Forschungen I*, f. 254.

<sup>8</sup> *Statuta et Ordinationes*, Capitulum XLVIII, f. 173.

<sup>9</sup> *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay, Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 468. (Cituar si: AAlb. I, nr.)

<sup>10</sup> “Michael Paleologus (!), Graecorum imperator in diplomate suo “per magnificum copitem Progonum Pastrovichium” misso, Michaeli Angeli et Andreae eius filio ducibus Drivasti privilegia a Leone I. imperatore concessa progenitoribus Michaelis et Andreae, “qui ut clare cognoscimus Drivastensem civitatem, ut in presentiarum iaceat, nec non ecclesiam cathedralem una cum domo canonicali canonica nuncupata, de propriis suis bonis fundarunt”, confirmat ” AAlb. I, nr. 468.

Sipas Shuflajt, kjo diplomë në të vërtetë është e falsifikuar dhe i përket shek. XVI, më saktë vitit 1567 dhe ka si autor Andrea Engjëllin, i cili njihej si falsifikator i famshëm gjenealogjish.<sup>11</sup> Pra, mbi themelimin e kësaj kishe nuk dimë vitin se kur, dhe se kush e themeloi. Pra mund të mos jenë Engjëllorët, kurse Mihael Engjëlli dhe i biri Andrea që përmenden në dokument kanë ekzistuar në gjysmën e parë të shek. XV, dhe si vit i vdekjes së Mihaelit jepet 1442.<sup>12</sup>

Është e dokumentuar se kjo kishë kishte edhe një fshat në posedimin e saj dhe në vitin 1410 si rrjedhim i varfërisë shumë të madhe që ekzistonte në Drisht dhe në krahinat përreth tij, për shkak të mosmarrëveshjeve dhe luftës që kishte plasur midis Balshajve dhe venedikasve disa kohë më parë,<sup>13</sup> sindakët e atyshëm Robertus Muroceno dhe Jakobus de Rippa, të bindur për varfërinë e atyshme i njoftuan ipeshkvit të Drishtit që fshati i kësaj kishe lirohej nga çdo tribut.<sup>14</sup> Me këtë veprim që dakord edhe Sinjoria, pasi vetë ipeshkvi iu ishte lutur atyre për këtë gjë dhe venedikasit qenë të bindur qoftë për varfërinë qoftë

<sup>11</sup> “*Documentum hocce a. 1567. confectum a dicto Andrea Angelo falsario genealogiarum famoso confectum ... fuisse nec ullum in historia fundamentum habere superfluum est habere.*” AAlb. I, nr. 468.

<sup>12</sup> “*Michael († 1442) filiusque ejus Andreas memoratur*” AAlb. I, nr. 468.

<sup>13</sup> B. Millutinoviç, “Drishti”, në: *Gjurmime Albanologjike, S. Sh. H. 15-1985*, f. 51.

<sup>14</sup> “*Viri mobiles ser Robertus Muroceno et ser Jacobus de rippa miles, qui fuerunt indici ad partes albanie aduertentes magnam paupertatem Ciuitatis driuastine ne iret in totalem desolationem, concesserunt Reuerendo patri domini episcopo driuastensi, deuoto et fidelj ostri dominij, quod villa Ecclesie Sancte Marie Episcopatus predicti et Incolle ac habitatores ipsius, qui pauperrimij sunt propter sterilitatem et incomoditatem situs ipsius uille, et eorum filij ibidem habitatores essent liberi, ab omia angaria, et solucione alicuius rei, sicut temper per elapsum fuerant Et nunc idem dominus Episcopus supplicauerit, ut de nostra solita clementia dictam concessionem, ad absolutionem datij confirmare dignaremus.*” Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Pars Secunda: Saeculi XV Praescanderbeganam Periodum complectentis. Tomus Sextus: Annos MCDX ad MCDXII illustrans. Centro internazionale di Studi Albanesi Palermo/ Istituto Universitario Orientale Napoli/ Istituto di Studi Albanesi del’ Universita di Roma/ Fondazione Giorgio Cini Venezia/ Ponteficio Istituto di Studi Orientali Roma/ Albanien Institut, Universität München/ Südost Institut, München / Institut für Geschichte und Kultur des Nahen Orients, sowie für Turkologie, Universität München. München: Rudolph Trofenik 1968, nr. 1538. (Cituar si: AAV VI, nr.)

për besnikërinë e banorëve ndaj zotërimit venedikas.<sup>15</sup> Emri i këtij fshati që ndodhej diku në rrethinat e Drishtit nuk jepet. Përveç luftës së Balshajve që kishin shkaktuar një varfërim të mëtejshëm, dy ndër shkaqet e tjera të varfërisë së këtij fshati, siç shihet në dokumentin e mësipërm ishte edhe steriliteti i madh i asaj toke të punueshme që gjithsesi ishte me pakicë, pasi fshati ndodhej në një zonë pyjore.<sup>16</sup>

Duke shfrytëzuar këto rrethana dhe qetësinë relative që ishte krijuar në këtë kohë midis luftash, edhe klerikë të tjerë mundohen të përfitojnë nga kjo. Një dokument i datës 26 prill 1410 flet për një klerik me emrin Novak, të cilit i ishte marrë shtëpia e tij e vogël, me qëllim që të zgjerohej dhe të bëhej sa më komode banesa për podestain e Drishtit, ku do të banonte me gjithë familje.<sup>17</sup> Kjo shtëpizë, mesa mund të verifikohet nga dokumenti, kishte qenë ngjitur me murin e shtëpisë së podestasë, në gjendje shumë të keqe (*paruam et sinistram habitationem*), dhe ishte përdorur nga podestai për afro tetë muaj.

Novaku për lëshimin e shtëpisë nuk kërkonte nga autoritetet venedikase një shpërblim në para, por u lut me mirësjellje për kompensimin e vlerës së shtëpisë me një sipërfaqe territori.<sup>18</sup> Kështu u mor vendim që ky kompensim t'i jepej atij nga toka shtetërore (pronë e Sinjorisë), pasi të verifikohej koha e përdorimit dhe shumat që ishin bërë për restaurimin e kësaj shtëpie.<sup>19</sup> Mesa duket ky klerik i përkiste kapitullit të kësaj katedrale.

<sup>15</sup> “*Vadit pars, Quod considerate fide et operibus ipsius domini Episcopi, ac etiam quod secundum informationem habitam dicta villa est situata per modum, quod cessante dicta absolute penitus relinquereetur inculta, quia est in loco siluestri et ualde extrattus (sic) ab alijs habitationibus super quodam monte sterilij ualde. Dicta concessio prout petit, sibi per nostras literat confirmetur. Et pro hoc scribetur potestatj nostrum driuasti prout fuerit oportutum. De parte ---omnes alij, de non --- 0, non sinceri – 1.*” AAV VI, nr. 1538.

<sup>16</sup> AAV VI, nr. 1538.

<sup>17</sup> AAV VI, nr. 1539.

<sup>18</sup> “*Sed de dicto casali suplicauerit, sibi gratiose de aliquot alio territorio pro ipso in recompensationem suam prouiderj*” AAV VI, nr. 1539.

<sup>19</sup> “*Vadit pars Quod mandetur rectori nostrum driuasti, quod debeat habita necessaria, et veridica informacione ab hominibus dende, prauot melius poterit de ualore dicti casalis, tempore dicte assignationis ut supra pro condigna recompensatione et restauo (?), secundum extimationem et informationem quam haberit de territorijs nostrsi dende satisfacere eidem prout eidem uidebitur*

Kësaj kishe iu dhuruan me anë testamentesh shuma të ndryshme parash. Këtu mund të përmendim dhurimin e Dom Pjetër Sumës nga Drishti. Ai ishte kapelan i kishës së Shën Vlashit në Raguzë dhe nga që ishte shumë i sëmurë bën testamentin më datë 9 shtator 1400 dhe me anë të tij i lë kësaj kishe dhe kanonikëve të saj 15 perperë për meshë.<sup>20</sup> Një dhurues tjetër i kësaj kishe ishte edhe dom Pjetër Lepore nga Drishti, i cili jetonte në Raguzë dhe i lë asaj me testament pesë dukatë për një çarçaf.<sup>21</sup> Kisha pra, siç shihet më sipër, kishte një histori qindra vjeçare. Pas pushtimit osman ajo u zhduk nga faqja e dheut së bashku me kanonikën dhe sot nuk mund ta lokalizojmë se ku mund të jetë ndodhur.

*Kisha e Vjetër e Shën Mërisë (Sancta Maria Veteris (1403) apo edhe kisha e Shën Mërisë së Truallit të Vjetër (Chiesa di S. Maria di Terra Vecchia).* Emra të tjerë të kësaj kishe janë edhe *S. Maria Vetus* dhe *S. Maria Civitate Veteri* (Shën Mëria e qytetit të vjetër). Ajo gjendej në pjesën e vjetër të qytetit, që mesa duket, pjesë e saj ishte edhe lagjja e Tregut që ndodhej në një kodër tjetër ballë për ballë me kodrën e qytetit, por me lartësi më të ulët, e cila ndryshe quhet edhe “*Kodra e Muzhilës*”.

Me sa duket, kisha *Sancta Maria Veteris* ishte më parë në patronazhin e Engjëllorëve. Ajo ishte edhe ipeshkvnore. Në kohën kur ipeshkvi zgjidhej nga Engjëllorët dhe aprovohej nga Patriarku i Konstandinopojës.<sup>22</sup> Në vitin 1403 kësaj kishe nga Venediku, iu dërgua një kabanë e re që u mor në dorëzim nga rektori i saj.<sup>23</sup> Emri i rektorit në dokumentin e cituar nuk përmendet.

---

*conueniens, atque Justum ita quod labeat causam contentandi, de parte --- omnes alij, de non --- 2, non sinceri - 0 ” AAV VI, nr. 1539.*

<sup>20</sup> *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV, (1400-1405), vëll. I, përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1987, nr. 64. (Cituar si: *Dokumente të Shek. XV. Vëll. I, nr.*)*

<sup>21</sup> *Po aty, nr. 420.*

<sup>22</sup> *“Jtem havevano la iurisdictione di elegere et conferire l’Episcopato di delta Cittade a chi gli pareva Jdoneo, che forse Episcopo, il mandavano fatto questo Episcopo dal Patriarca a Costantinopoli a confermare tal eletione il quale ordinariamente confirmavano”. *Dokumente të shekujve XVI–XVII për Historinë e Shqipërisë (1507-1592), Vëllimi I, përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989, nr. 164. (Dokumente të Shek. XVI-XVII, Vëll. I, nr.)**

<sup>23</sup> *“Mittentur Drivastum “due campane accepte per nostros de ecclesiis s. Marie veteris et s. Francisci et posite ad servicium communis”. Acta et Diplomata*

Një kishë tjetër që ndodhej në Drisht ishte edhe *Katedralja e Shën Gjergjit* (1400),<sup>24</sup> e cila kishte edhe një shkollë (vëllazëri).<sup>25</sup> Dom Pjetër Suma nga Drishti, kapelan i kishës së Shën Vlashit në Raguzë, me anë të testamentit të tij më datë 9 shtator 1400 u lë kanonikëve të kësaj kishë 10 perperë.<sup>26</sup> Kjo kishë kishte edhe kapitull kanonikësh dhe kanonikët e saj jetonin së bashku në një shtëpi kanonikale me kanonikët e kapitullit të Shën Mërisë.<sup>27</sup> Pra, Drishti kishte dy katedrale. Më tej kisha të tjera që përmenden nëpër dokumente janë:

*Kisha e Shën Kryqit*, e cila, sipas burimeve kishte edhe një shkollë (vëllazëri).<sup>28</sup>

*Kisha e Shën Stefanit*.<sup>29</sup>

*Kisha e Shën Françeskut*, e cila përmendet shumë rrallë nëpër dokumente. Kësaj kishë, (ashtu si dhe kishës së Shën Mërisë së vjetër që përmendëm më sipër) në vitin 1403 iu dërgua nga Venediku, një kabanë e re që u mor në dorëzim nga rektori i saj emri i të cilit nuk përmendet në dokument.<sup>30</sup>

*Kisha e Shën Shelbuemit* (Sancti Salvatore)<sup>31</sup> (1399), të cilës Pjetër Skipudari (*Petrus Schipudar*) i lë me testament më 29 janar (1399) një parament (shtröjë).<sup>32</sup>

*Kisha e Shën Prendës* (Shna Premtes)<sup>33</sup> (1400). Kësaj kishë Dom Pjetër Suma nga Drishti, (kapelan i Shën Vlashit në Raguzë) i lë me

*res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 continens Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 728. (Cituar si: AAlb. II, nr.)

<sup>24</sup> Ermano E. Armao, *Vende, Kisha lumenj, male e toponime të ndryshme të një harte të lashtë të Shqipërisë Veriore*, Tiranë: Korbi, 2006, f. 73. (Në vijim cituar si: E. Armao: *Vende*, f.)

<sup>25</sup> *Statuta et Ordinationes*, f. 55.

<sup>26</sup> *Dokumente të Shek. XV*, Vëll. I, nr. 64.

<sup>27</sup> AAlb. I, nr. 468.

<sup>28</sup> *Statuta et Ordinationes*, f. 55.

<sup>29</sup> Gjon Berisha, *Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI-XV*, Disertacion, Tiranë: Qendra e e Studimeve Albanologjike 2013, f. 284.

<sup>30</sup> "Mittentur Drivastum "due campane accepte per nostros de ecclesiis s. Marie veteris et s. Francisci et posite ad servicium communis". AAlb. II, nr. 728.

<sup>31</sup> E. Armao: *Vende*, f. 73.

<sup>32</sup> AAlb. II, nr. 615.

testament të datës 6 shtator 1400 një kelk (kupë) të argjendtë që kishte si vlerë 30 perperë.<sup>34</sup>

*Kisha e Shënkollit (Ecclesia S. Nicolai sub civitate veteri)* që sipas burimeve gjendej nën varoshin e vjetër.<sup>35</sup> (shih *Rrënojat e kishës A*)

*Kisha e Shpirtit të Shenjtë (Sancti Spiritus)* ? Në fakt në statutet e Katedrales së Drishtit, në atë kapitull (XI), në të cilin flitet për ceremonitë e veçanta (për ditën e të vdekurve) përmendet edhe mesha e veçantë për nder të Shpirtit të Shenjtë, ashtu si për nder të Kryqit të Shenjtë dhe të së Lumes Mari,<sup>36</sup> të cilat presupozoj që janë thënë në kishat përkatëse. Mos ndoshta kjo lë të kuptojmë që në Drisht kishte edhe një kishë të Shpirtit të Shenjtë?

### Rrënoja kishash anonime të Drishtit

Përveç kishave të dokumentuara që përmenda më sipër të cilat janë të identifikuar me emër, por që nuk u dihet vendndodhja, në Drisht ka edhe katër të tjera, rrënojat e të cilave gjenden dhe mund të shihen akoma edhe sot, porse nuk mund të identifikohen. Të parën po përshkruajmë kishën që ndodhet buzë rrugës së kalldrëmtë poshtë mureve të qytetit.




Fig. 1: *Rrënojat e Kishës A*. Foto E. Malaj

Skicë 1: *Kisha A*. Vizatimi nga E. Malaj

<sup>33</sup> E. Armao: *Vende*, f. 73.

<sup>34</sup> "Item lasso a Sancta Veneranda in Driuasto kalese uno de argento de valor XXX iperperi." *AAlb.* II, nr. 656.

<sup>35</sup> "Sub Driuasto apud ecclesiam S. Nicolai sub civitate Veteri". *AAlb.* II, nr. 99, f. 43; krh. Aleksandër Meksi, *Arkitektura e kishave të Shqipërisë (Shekujt VII-XV)*, Tiranë: Eugen, 2004, f. 142-143; krh. edhe: E. Armao: *Vende*, f. 73.

<sup>36</sup> *Statutet dhe Urdhëresat*, kap. XI, f. 149-150.


Kjo kishë ka këto dimensione: Gjatësia 4.46 m x 3.11 m gjerësi, absida me diametër 155 cm. Muret e saj kanë një trashësi prej 58-60 cm dhe janë prej guri të lidhur me rërë lumi me gëlqere. Lartësia e tyre arrin deri në 1.60 m.<sup>37</sup> Kisha është e drejtuar me absidë nga lindja. Siç mund të shihet edhe në fotot dhe në skicën e mëposhtme, sot ekzistojnë vetëm pjesa e absidës me njërin anë (muri anësor i djathtë), kurse ana nga rruga e kalldrëmit (muri i majtë) nuk ekziston më.

Nuk mund ta vërtetoj nëse kjo kishë mund të ketë qenë vërtetë *kisha e Shënkollit (Ecclesia S. Nicolai sub civitate veteri)*, edhe pse ndodhet nën qytetin e vjetër (*sub civitate veteri*) si rrjedhim po e emërtoj me *Kisha A*.

Një kishë tjetër e paidentifikuar është gjetur në muajt e fundit brenda mureve të qytetit, jo shumë larg qendrës së sheshit të sotëm. Gërmimet për gjetjen e saj i ka bërë një fshatar që banon aty, i cili duke punuar në oborrin e shtëpisë së tij të vjetër kishte vënë re një strukturë që vazhdonte vertikalisht në thellësi. Pasi bëri gërmime të kujdesshme sipas tij, doli në pah faqja ballore me absidën e një kishe të vogël me një pjesë të murit anësor të djathtë. Kjo faqe është e suvatuar dhe mbi të shihen me vështirësi edhe gjurmët e një piktore murale. Lartësia e saj arrin në 2.55 m, gjerësia e saj është 2.76 m, kurse absida ka një diametër prej 130 cm.<sup>38</sup> Kisha është e drejtuar me absidë nga lindja. Këtë kishë po e përcaktojmë me *Kisha B*. Gjatë gërmimeve që bëri ky fshatar kanë dalë në pah edhe copa të shumta qeramike, siç mund të vihen re edhe në figurë.



Fig. 2: Rrë nojat e Kishës B. Foto E. Malaj.



Skicë 2: Kisha B. Vizatimi nga E. Malaj

<sup>37</sup> Matjet në *Kishën A* janë kryer personalisht nga unë (E. M.), në mars 2014.

<sup>38</sup> Matjet në *Kishën B* janë kryer personalisht nga unë (E. M.), në mars 2014.

Sipas Jirečekut, midis qytetit dhe kështjellës ndodheshin rrënojat e një *kapele të vogël me tre altarë të rrumbullakët*.<sup>39</sup> (fig. 3 dhe skicë 3) Duke ndjekur udhëzimet e tij gjeta edhe kishëzën me tre altarë që nuk ndodhet larg nga porta verilindore e qytetit, disa dhjetëra metra mbi rrugën kryesore që përshkon sheshin kryesor.




Fig. 3: Rrënojat e Kishës C. Foto. E. Malaj. Skicë 3: Kisha C. Vizatimi nga E. Malaj

Kjo kishë ka afërsisht këto dimensione: gjerësia 2.55 m x 3.50 m gjatësi, diametri i tri absidave është 1.47 m, hapësira e derës është 128 cm, ndërsa lartësia e mureve që sot janë në këmbë është vende-vende 2.27 m, trashësia e mureve varion midis 61 cm dhe 57cm.<sup>40</sup> Muret janë tërësisht prej guri dhe janë të lidhur me rërë lumi dhe gëlqere. Sot për sot nuk jemi në gjendje të përcaktojmë se cili mund të ketë qenë emri i saj. Banorët e sotëm të zonës vendin ku ndodhet ajo e quajnë “te kisha”. Edhe kjo kishë është e drejtuar me absidë nga lindja. Këtë kishë po e përcaktoj me *Kisha C*.

Siç e thashë edhe më sipër nga vërtetimet që bëra në pjesën e tregut të dikurshëm të qytetit, mbi *Kodrën e Muzhilës*, konstatova mbetjet e një kishe relativisht të vogël, për të cilën mendoj se nuk janë rrënojat e kishës së lartpërmendur *Sancta Maria Veteris*, ngaqë dimensionet e saj 4 m x

<sup>39</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në: *Forschungen I*, f. 111. (Cituar si: K. Jireček, “Skutari”, në: *Forschungen I*, f. 111.

<sup>40</sup> Matjet në *Kishën C* janë kryer personalisht nga unë (E. M.), në mars 2014.

2.60 m (me rreze të absidës 110 cm) të japin përshtypjen se ajo ishte një kapelë që përdorej për ceremonitë e varrimit.<sup>41</sup>





Fig. 4: Rrënojat e Kishës D në kodrën e Muzhilës.  
Foto E. Malaj



Skicë 4: Kisha D.  
Vizatimi nga E. Malaj

Kisha është e drejtuar me absidë nga lindja. Këtë hipotezë e mbështet pak edhe vendndodhja e një varri të hapur kohët e fundit (mars 2014) që gjendet aty pranë, gjë që na bën të mendojmë se aty mund të ketë qenë një varrezë, pasi gropëza të tilla (të hapura kohë më parë) shihen gjithkund nëpër atë zonë, të cilat mund të jenë hapur nga banorët e zonës apo persona të tjerë, ose për t'i grabitur ose, sepse mendohet se në Drishtin e vjetër është fshehur një thesar që nuk është gjetur akoma edhe sot.

Këtë thesar, sipas mendësisë së popullsisë e paskan fshehur dikur ushtarët turq, të cilët e kishin grumbulluar atë duke grabitur zonat përreth.<sup>42</sup> Këtë kishë po e përcaktojmë *Kisha D*. Kurse në lidhje me ekzistencën e varrezave na japin një të dhënë indirekte edhe *Statutet e*

<sup>41</sup> Matjet në *Kishën D* janë kryer personalisht nga unë (E. M.), në mars 2014.

<sup>42</sup> Sipas banorëve, në Drisht kanë ardhur edhe të huaj, sidomos nga Turqia që banorët e quajnë “piratët e arit”, cilët ishin të pajisur edhe me harta të vjetra dhe me aparatura kërkimi. Ata vini ditën si turistë dhe natën bënë gjurmime. *Shih*: Ardi Hoti, “Kalaja e Drishtit. Ku varfanjakët kërkojnë një thesar”, në: *Shqip*, VIII/ Nr. 321 (971), dt. 20. 11. 2008, f. 25.

*Kapitullit të Katedrales së Drishtit*, ku thuhet se, çdo të hënë duhej të thuheshin meshë për të vdekurit që i kishin lënë prona, pasuri dhe lëmosha kishës, dhe se kjo meshë shoqërohej me procesion nëpër varrezë (*cum procesione per cimiterum*).<sup>43</sup>

Kishat e vogla të lartpërmendura (A, B, C, D) mund të kenë qenë edhe nga ato kapelat që qyteti duhet të ketë pasur përreth ndoshta në numër të konsiderueshëm, pasi në statutet e kapitullit, ato përmenden në numrin shumës dhe thuhet se nëpër to ishte zakon të bëhej procesion dhe se ata kanonikë që nuk pranonin të shkonin duhet të paguanin dy groshë gjobë.<sup>44</sup>

Mbi rrënoja kishash na njofton edhe konsulli francez i Shkodrës Luiz Hiacint Hekard, i cili thotë se “*aty-këtu shihen edhe mbetjet e kubeve dhe themelet e një kisha të lashtë, që është shkatërruar këto vitet e fundit nga kërkuesit e thesareve.*”<sup>45</sup> Por ai nuk e specifikon se ku ndodheshin këto rrënoja, kështu që mund të jenë edhe të ndonjërës prej atyre që kam përshkruar më sipër.

Megjithatë në lidhje me kishat Hekard na jep edhe një informacion tjetër



Fig. 5: Porta e xhamisë me rozon sipër. Foto P. Pushimaj.

<sup>43</sup> *Statuta et Ordinationes*, Capitulum X, f. 149.

<sup>44</sup> “*Quod iussus ire cum procesione ad capellas, cadat in penam Capitulum XIII<sup>o</sup> Quoniam conservimus ire processione ad capellas quas habemus, statuimus ut is, cui mandatit rector, vadat cum procesione. Si recusaverit ire, solvat grosos duos, ut supra exigemos.*” *Statuta et Ordinationes*, f. 151.

<sup>45</sup> Hyacinthe Hecquard, *Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë*, përktheu nga frëngjishtja dhe pajisi me shënime Oriana Tamburi, Tiranë: Plejad, 2008, f. 144. (Cituar si: H. Hecquard, *Historia*, f.)

me rëndësi kur thotë, se aty (në Drisht) “*ka një xhami të ndërtuar mbi rrënojat e një kishe të lashtë*”<sup>46</sup>. Kjo xhami e vjetër qëndron akoma në qendër të fshatit të vjetër, përdoret rrallë dhe pjesën më të madhe të kohës është e mbyllur. Në lidhje me ndërtimin e saj, banorët e pyetur aty nuk mbajnë mend ndonjë tregim a legjendë që mund t’u jetë trashëguar. Gjurmëve kishtarë të këtij objekti (xhamie) po u vëmë emrin “*Kisha E*”. Përsa i përket gjurmëve të arkitekturës kishtarë tek kjo xhami, në faqen ballore të saj, sipër derës shihet një *rozon* në formë ovale që më vonë është mbyllur. Një rreth i tillë oval mbi portën e një xhamie është diçka e pazakontë dhe kjo të çon në mendimin se mund të ketë qenë pjesë e ndonjë kishe të vjetër.

Ky *rozon* është mbyllur me material tjetër, më të dobët dhe gërryerja nga agjentët atmosferik ka nxjerrë në pah fare qartë ekzistencën e tij me pamje të plotë. Rozonet gjenden gjithmonë sipër portave të kishave katolike dhe në shumicën e rasteve janë dritare në formë rrumbullake, që shërbejnë si elementë dekorativë dhe që simbolizojnë dominimin e Krishtit dhe të Krishterimit në Botë, sepse në shumë raste, ata kishin në qendër ose një kryq ose figurën e Jezus Krishtit. Përveç kësaj një element tjetër që të çon në supozimin se kjo xhami ka qenë kishë dikur, është edhe forma e saj drejtkëndore (e jo katrore siç është në rastin e xhamive të ndërtuara që në fillim si të tilla). Pastaj një arsye tjetër që forcon këtë supozim është edhe zakoni që kishin pushtuesit osmanë, kur pushtonin lokalitete të tilla të krishtera. Ata zakonisht kthenin në xhami kishën kryesore të qytetit a fshatit që pushtonin, që ndodhej në qendër, kurse të tjerat ose i shkatërronin fare, ose i linin ashtu siç ishin.

Ndërtesa e xhamisë në fakt nuk është e drejtuar nga lindja, si rrënojat e kishave të tjera në Drisht, por nga veriu, por kjo nuk është një rregull absolut, sepse ka kisha që janë të orientuara edhe nga veriu. Gjatë këqyrjes së kësaj xhamie nuk munda të eidentoj ndonjë gjurmë tjetër dhe nuk mu dha mundësia që të vizitoj xhaminë edhe nga brenda, pasi është e mbyllur. Mbase një specialist arkeolog që merret me kishat e periudhës mesjetare dhe me fenomenin e shndërrimit të kishave në xhami (mesxhide), mund të eidentojë gjurmë më të qarta.

---

<sup>46</sup> *Po aty.*

### Abacia e Shën Gjonit të Rashit

Edhe pse ndodhet disa kilometra larg, në dioqezën e Drishtit bënte pjesë edhe Abacia e Shën Gjonit të Rashit (*abbatia s. Johannis de Strilalio districtu Drivasti*), për të cilën po flas më poshtë në mënyrë të zgjeruar, pasi është një monument i rëndësishëm jo vetëm i Ipeshkvisë së Drishtit në veçanti, por edhe i historisë së gjithë kishës katolike shqiptare në përgjithësi.

Sipas Jirečekut, nën malin Maranai që në shek. XV e gjejmë të dokumentuar me emrin *Marinaa* ose *Marinay*, pesë milje larg nga kisha ipeshkvnore shumë më e re e Balecit,<sup>47</sup> shtrihej manastiri benediktin i Shën Gjonit, me një këmbanare shumë të lartë, të ndërtuar me gurë të gdhendur katrorë, që në vitin 1356 u vu nga Papa nën juridiksionin e ipeshkvit të Balecit, gjë që do ta përmendim edhe më poshtë. Rrënojat e këtij manastiri, një kullë katërkëndëshe me mbetjet nga kisha dhe nga ndërtesat e manastirit ndodhen në fushën e Shtojit, në veri të qytetit të Shkodrës, tek fshati Rasha (Raši). (*in valle Štoj (rivus Fuča-Štoj) in pago Rači, urbis Scodra ad Septemtrionem*) në fillim të shek. XX<sup>48</sup> në një gjendje më të mirë nga ç'janë sot. Aty në afërsi kalon edhe përroi i Banushit dhe sipas Kordinjanos pikërisht aty ndodhej edhe rruga që të çonte për në Balec,<sup>49</sup> e cila duhet të ketë lidhur edhe Drishtin qoftë me manastirin, qoftë me qytetin e Balecit. Më tej kjo rrugë të çonte në Koplik.<sup>50</sup>




Fig. 6: Rrënojat e Manastirit.  
Foto nga Ippen.

<sup>47</sup> K. Jireček, "Skutari", në: *Forschungen I*, f. 114.

<sup>48</sup> *AAlb.* I, nr. 93, ref. 3. Shih edhe K. Jireček, "Skutari", në: *Forschungen I*, f. 114.

<sup>49</sup> Fulvio Cordignano "Antichi monasteri benedettini e le loro benemerenze sociali in Albania", në: *La Civiltà Cattolica*. Anno 80 – 1929, vol III, f. 17 (në vijim cituar si: F. Cordignano "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f.)

<sup>50</sup> O. Schmitt, *Das venezianische Albanien*, f. 85.

Manastiri është i mbuluar edhe me legjenda popullore, njërën ndër të cilat na e sjell edhe ati jezuit Fulvio Kordinjano (P. Fulvio Cordignano S.I.). Legjenda tregon se themelueset ishin tri motra mbretëresha, të bijat e një mbreti që vdiq pa lënë djem. Edhe ato për të lënë një emër të lavdishëm vendosin të ndërtojnë tri kisha për “sevap” edhe për dashurinë ndaj Hyjit. Këto kisha ishin: ajo e Shurdhahut (Sardës), ajo e Shatit, kurse e treta ajo e Rashit.<sup>51</sup>

Këto tri kisha duhej të ishin njësoj dhe këmbanaret e tyre duhej të kishin të njëjtën lartësi, në mënyrë që motrat, nga këmbanaret e tyre të mund të shiheshin, të thërrisnin dhe të bisedonin me njëra tjetrën kur të donin. Kisha e Rashit, njësoj si dy kishat e tjera simotra, kishte sipas legjendës 366 altare, pra çdo ditë të vitit i ishte caktuar një altar. Ndërsa një legjendë tjetër, e sjellë po nga Kordinjano, nuk përmend tri motrat mbretëresha, por një murgeshë të vjetër, si themeluese të këtyre tri kishave.<sup>52</sup> Le të kthehemi tani përsëri në histori të dokumentuar.



Fig. 7: Rrënojat e manastirt sot, me këmbanaren e riparuar në vitin 2012.  
Foto E. Malaj.

Ky manastir benediktin në dokumente të ndryshme ndeshet me emra të ndryshëm si *Manastiri i Shën Gjonit, i urdhrit Benediktin, i dioqezës së Drishtit (monasterium s. Johannins Ordinis s. Benedicti Drivastensis diocesis)* në vitin 1357<sup>53</sup>, apo *Abacia e Shën Gjonit të Strilalit të distriktit të Drishtit* në vitin 1408<sup>54</sup> (*abbatia s. Johannis de Strilalio districtu Drivasti*), apo ‘Manastiri i Shën Gjonit të Strilalit, i urdhrit Benediktin, i

dioqezës së Drishtit’ (*monasterium s. Johannins de Strilalio Ordinis s. Benedicti Drivastensis diocesis*) në vitin 1459.<sup>55</sup>

<sup>51</sup> E gjithë përmbajtja e kësaj legjende është marrë nga: F. Cordignano, “Antichi monasteri”, në: *La Civiltà Cattolica*. 1929/IV, 107, f. 410.

<sup>52</sup> Po aty, f. 412.

<sup>53</sup> *AAlb.* I, nr. 93, ref. 3.

<sup>54</sup> Po aty.

<sup>55</sup> Po aty.

Manastiri nëpër dokumente përmendet për herë të parë më 16 qershor të vitit 1166 në aktin e shugurimit të kishës së Shën Trifonit në Kotorr, ku përveç ipeshkvit të Kotorrit Maio, ipeshkvit të Arbërit Lazrit, (*Lazaro Albanensi*), ipeshkvit të Ulqinit Gjonit (*Johanne episcopo Dulcinensi*), morën pjesë dhe shumë abatë ndër ta dhe *Mihaeli, abati e manastirit benediktin të Shën Gjonit të Shtojit (Strilalio)*,<sup>56</sup> siç quhej në një dokument tjetër, manastiri i Rashit.

Drishtjanët e konsideronin manastirin pronë të tyre dhe sipas një dekreti të qartë të shek. XV, abati i manastirit duhej të ishte gjithmonë një drishtjan (*semper in futurum abbas sit Drivastinus*).<sup>57</sup>

Ngaqë të ardhurat e kishës së Balcit në këtë kohë qenë pakësuar aq shumë nga skizmatikët e Mbretërisë së Rashës, ipeshkvi i Balcit nuk kishte me se të jetonte, dhe për këtë arsye, atij, nga Papa Inocenti VI, rreth datës 26. 10. 1356 iu dha si komendë manastiri benediktin i Shën Gjonit në Shtoj (Strilaleo) që ndodhej në dioqezën e Drishtit.<sup>58</sup> Pra, dioqeza e Drishtit, por edhe rrethi përfshinin brenda tyre edhe fushën e Shtojit deri në afërsi të qytetit të Balcit. Ky manastir pati probleme të shumta nga ortodoksët sllavë, ashtu siç pati edhe ipeshkvia e Balcit në

<sup>56</sup> “1166, 19. Iunii ,<Cathari> Maio episcopus <Catharensis> cum “episcopis Lazaro Albaniensis et cum et cum Martino Drivastensis et cum Johanne episcopo Dulcinensi” “adiunctis abbatibus: Michaelle abbate (archimandrita) Sancti Johannis et cum Petro abbate (archimandrita) sanctorum Sergii et Bachi et Johannes abbate sancte Salvatoris Antibareinsis et Petro abbate sancti Michaelis Catarensis et Triphone abbate sancte Marie Buduensis et petro abbate sancti Petri et Johannes abbate sancte Georgii et georgio abbate sancti Salvatoris Arbanensis” ecclesiam sancte Triphoni consecrat, quidem altare medium ipse Maio, “aliud altare a sinistro latere sacravit Lazarus”, “a dextro videlicet latere sacravit altare Johannes episcopus Dulcinensis”. “in sede apostolica residente papa Alexandro, imperante piissimo et temper triumphatore Hemanuele, duce existente Dalmatie atque Dioclie kyr Izancio, qui in eadem dedicatione sua gratuita voluntate et benignitate affuit, priore Vita existente in Cataro; Petrus Soacinensis electus interfuit et Andreas prior Arbaniensis cum toto populo civitatis.” AAlb. I, nr. 93. Krahaso edhe: F. Cordignano “Antichi monasteri”, në: La Civiltà Cattolica. 1929, vol III, f. 17.

<sup>57</sup> K. Jireček, “Skutari”, në: *Forschungen I*, f. 114; Shih edhe: M. Šufflay, “Kirchenzustände”, në: *Forschungen I*, f. 270. Shih edhe: F. Cordignano “Antichi monasteri”, në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 18.

<sup>58</sup> AAlb. II, nr. 119. Shih edhe: F. Cordignano “Antichi monasteri”, në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 18.

afërsi të tij, sepse në vitin 1356 thuhet se Abacia e Shën Gjonit në Drisht ishte shkatërruar krejtësisht nga ortodoksët (*ab ipsis schismaticis quasi totaliter dissipatum*).<sup>59</sup> Gjatë kësaj kohe posti i abatit të manastirit ishte vakant, sepse abati i saj më i fundit që quhej Andrea, kishte vdekur.<sup>60</sup> Papa Inocenti me këtë rast bën edhe një histori të shkurtër dhe një përshkrim të dioqezës së Balecit. Në atë kohë ipeshkëv i Balecit ishte Andrea.<sup>61</sup>

Ky manastir, me gjithë kërcënimin skizmatik, u ringrit shumë shpejt, pasi 20 vjet më vonë gjejmë se Papa Gregori XI urdhëron më 29. 2. 1376 Pjetrin, arqipeshkëv të Raguzës, që të zgjedhë ndonjë murg benediktin të atyre vendeve dhe që ta caktojë si abat, pasi abati i fundit Mihael kishte vdekur "*monasterio S. Johannis Baptiste dicti ordinis Drivastensis diocesis, per obitum Michaelis abbatis vacanti*"<sup>62</sup>. Pra, për shek. XIV mësojmë emrat e dy prej abatëve të këtij manastiri, që ishin Andrea dhe Mihaeli.

Gregori XI i propozon arqipeshkëv Pjetër të Raguzës, që Mihaeli, abati i vdekur i këtij manastiri të zëvendësohet ose nga Paska (*Pascha*) që ishte prior (igumen) i Shën Mikelit të Peklinës (*S. Michele di Peclina*),

<sup>59</sup> "(1356) 26 octobris. Innocentius VI. papa, "Andree episcopo Balazensi" "*monasterium S. Johannis ordinis S. Benedicti Drivastensis diocesis in regno Russie consistens et ab ipsius regni schismaticis quasi totaliter dissipatum, per obitum quondam Andree ultimi abbatis dicti monasterii, qui catholicus exstitit et extra Romanam curiam diem clausit postremum, vacans, quod ab ecclesia Balazensi per quinque dumtaxat millia parva distat – dat in commendam, ne mendicare cogatur, ecclesia Balazensi in prefato regno consistente ab eisdem schismaticis destructa*". AAlb II, nr. 119. Shih edhe: M. Šufflay, "Kirchenzustände", në: *Forschungen I*, f. 278.

<sup>60</sup> Giuseppe Valentini / Fulvio Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh për historinë e Shqipërisë (1200-1500)*, përktheu nga origjinali Vladimir Bregu, Tiranë: Plejad, 2013. (= Plejada e Mendimit albanologjik. Seria "Valentini") nr. 130 (Cituar si: G. Valentini/ F. Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh (1200-1500)*, nr.) *Krahaso edhe: AAlb. II*, nr. 119.

<sup>61</sup> G. Valentini, F. Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh (1200-1500)*, nr. 130.

<sup>62</sup> Rrënojat e Manastirit në Rrash-Kullaj, Boriç – Malësi e Madhe (Shqipëri) URL:

<http://www.kishakatolikeshkoder.com/famullite/Manastiri%20i%20Shen%20Gjinit/Manastiri%20alb.htm> (2. 8. 2012). Krahaso edhe: G. Valentini/ F. Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh (1200-1500)*, nr. 163.

ose nga murgu shqiptar Paolo Bossato (Bushati), i cili në atë kohë shërbente në kishën e Shën Mërisë në ishullin Treme (*S. Maria di Treme*), ose nga ndonjë tjetër.<sup>63</sup> Se cili u vu në krye të manastirit, këtë nuk mund ta mësojmë nga dokumentet dhe literatura deri tani të disponueshme, por historia e manastirit vazhdon edhe më tej dhe aty këtu hasim edhe të dhëna të tjera sporadike, të cilat po i jap edhe më poshtë.

Më 7 maj të vitit 1403, senati i Venedikut me anë të presbiterit Andrea që ishte ambasador i komunitetit të Drishtit, i dërgon një përgjigje negative kërkesës së abatit të këtij manastiri, për të mos pagur taksën e një të dhjetës.<sup>64</sup> Emri i abatit në këtë dokument nuk përmendet. Kur në vitin 1437, arqipeshkvi i Korfuzit u emërua si komendatar i manastirit, papa ia këshilloi atë edhe despotit serb.<sup>65</sup>

Kur plasi lufta midis Balshës III dhe Venedikut abatët e këtij manastiri që ishin me Venedikun vuajtën shumë për çështjen e Republikës.<sup>66</sup> Manastirit iu bënë shumë dhurata nga venedikasit. Ndër të tjera, atij, në vitin 1445 iu dhurua edhe një fshat i tërë (*villa Veronika*).<sup>67</sup> Abati i këtij manastiri përmendet për herë të fundit në vitin 1459 në regjistrat e papës Piu II, por mesa duket pa emër.<sup>68</sup>

Ky manastir, të cilit i kishin dhuruar edhe despotët serbë po aq shumë sa edhe manastirit të Shën Shirgjrit, apo abacisë së Rotecit, gëzonte një respekt të madh gjatë shekujve edhe nga popullsia ortodokse e krahinave përreth; madje akoma në shek. e mëparshëm (1855-1869) ortodoksët sllavë të Vrakës dhe katolikët e Rash-Kullajve u grindën egër para kajmekamit turk, për të pasur rrënojat e manastirit. Kajmekami kësaj gjendjeje i dha fund duke vënë përreth rrënojave një gardh dhe duke iu

<sup>63</sup> G. Valentini/ F. Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh (1200-1500)*, nr. 163.

<sup>64</sup> "1403, 7. maii. Venetiis. Petitioni, ne possessiones abbatie s. Johannis de Strilalio de districtu Drivasti deciman solvant, non complacetur, cum dicte possessiones rusticis affictentur". AAlb. II, nr. 728. Shih edhe: Cordignano, "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 18.

<sup>65</sup> M. Šufflay, "Kirchenzustände", në: *Forschungen I*, f. 271.

<sup>66</sup> Po aty. Shih edhe: F. Cordignano "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 19.

<sup>67</sup> M. Šufflay, "Kirchenzustände", në: *Forschungen I*, f. 271; Jules Alexandre Théodore Degrand, *Souvenirs de la Haute-Albanie*. Par A. Degrand, Consul de France. Paris: H. Welter 1901, f. 82 (Cituar si: A. Degrand, *Souvenirs*, f.); F. Cordignano "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 19.

<sup>68</sup> A. Degrand, *Souvenirs*, f. 82.

ndaluar të dy konfesioneve që të bënin shërbesa fetare tek këto rrënoja.<sup>69</sup> Ai i deklaroi rrënojat si pronësi muslimane, dhe kështu siç njoftojnë Degrandi dhe më vonë edhe Kordinjano, e drejta e pronësisë u përdor aq shumë nga muslimanët sa që ata, që banonin sidomos nëpër rrethina e ndihmuan punën shkatërruese që kishte ushtruar koha mbi këtë manastir, duke marrë për nevojat e tyre gurët e manastirit.<sup>70</sup>

Nga kjo grabitje e materialit e pësoi edhe këmbanarja, të cilën këta banorë gjatë fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, e ulën deri në tre metra më poshtë, duke i marrë gurët e gdhendur në formë kubi për shtëpitë apo edhe për zbulurim të varreve të tyre.<sup>71</sup>

Nga rrënojat e këtij manastiri sot nuk ka mbetur shumë, kurse kulla katërkëndëshe që përmend Jirečeku është riparuar, jo plotësisht, në vitin 1991 nga popullsia dhe kleri. Aty çohet meshë edhe sot në raste festash tek një altar i improvizuar jashtë në vend të hapur, para të cilit janë vëne edhe disa radhë ndejse betoni. Ky vend vizitohet vazhdimisht edhe sot e kësaj dite nga njerëz me halle që kërkojnë aty ngushllim dhe prehje shpirtërore. Kështu, në një vizitë aty, kur kisha shkuar për të bërë disa matje, vjen një grua në moshë me pamje të përvuajtur, bëri kryq tek porta hyrëse, e përsëriti këtë veprim tek disa rrënoja dhe tek kryqi i madh i bardhë, i vendosur aty kohët e fundit. Ajo vendosi një tufë me lule tek një figure të vendosur tek këmbanorja dhe filloi të lutej.


Përveç rrënojave të sipërpërmendura ka edhe edhe mbetje nga ndërtesa të tjera të manastirit dhe nga muri rrethues i tij, rrënojat e të cilit ngrihen herë herë edhe mbi një metër mbi sipërfaqe. Siç thashë edhe më sipër, unë e kam vizituar manastirin disa herë dhe jam përpjekur që të bëj edhe disa matje të kishës dhe të këmbanores. këto matje po i sjell më poshtë, qoftë në formë teksti, qoftë si skicë. Për të bërë matjet e kësaj kishe qe mjaft punë e vështirë dhe e rrezikshme për shkak të ferrave të shumta e të dendura dhe të gjarpërinjve që qisnin kokën aty-këtu. Kështu në disa raste nuk pata mundësi që t'u afrohesha mureve ashtu si dëshiroja dhe si rrjedhim rezultatet e mëposhtme janë të përafërta dhe mund të kenë një diferencë prej disa centimetrash.

<sup>69</sup> K. Jireček, "Skutari", në: *Forschungen I*, f. 114; A. Degrand, *Souvenirs*, f. 84.

<sup>70</sup> F. Cordignano "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 19.

<sup>71</sup> A. Degrand, *Souvenirs*, f. 84; F. Cordignano "Antichi monasteri", në: *La Civiltà Cattolica*. 1929, vol III, f. 19.

Kisha është shumë e madhe. Ajo ka një gjatësi mbi 22 metra dhe një gjerësi me gjithë mure rreth 860 cm. Muret ekzistuese janë pothajse fare të rrënuara dhe vende-vende ngrihen deri mbi 100 cm. Punimi i murit është i trashë, me gurë lumi të rumbullakët dhe me rërë lumi e gelqere, megjithatë vihen re edhe glendje të stilizuara në formë gërsheti, sidomos tek porta. Muret kanë afërsisht një trashësi prej 60 cm.



Skicë 5: I. Areali i Manastirit të Shën Gjinit; II. Kisha e manastirit me këmbanore.  
Vizatur nga Edmond Malaj

\* \* \*

Pra, duke u bazuar në literaturën e botuar dhe në dokumentet e shfrytëzuara, këto mund të thuhet deri tani në lidhje me monumentet kishtarë të Drishtit mesjetar, me shpresën se në të ardhmen në punime të tjera do të mund të jepet një tablo edhe më e plotë e tyre, duke u bazuar në studime të tjera dhe në dokumente, por edhe në të dhëna që mund të vijnë nga arkeologjia.

### *S u m m a r y*

#### ECCLESIASTICAL MONUMENTS OF DRIVASTO DURING THE MIDDLE AGE

Before the Ottoman conquest, the Diocese of Drishti (Drivasto) had many churches and chapels and the researchers qualified it as a nursery of Albanian Catholic clergy in the Middle Age. The churches of Drishti were thick-walled and so far we know this city had these cathedrals and churches: St. George's Cathedral, Cathedral of St. Mary with chapter, the church of St. Francis, St. Salvador's church, the church of St. Cross, the church of Sancta Maria Veteris, St. Stephen's Church, the Church of St. Veneranda, and the church of St. Nicholas. The incomes of these churches were, among others, testaments left by clerics and others who donate different amounts to them for the salvation of their own souls. Besides the aforementioned churches, I have also identified ruins of four other churches, which may have been even any of those mentioned above, but it cannot be confirmed yet, because the churches mentioned by name cannot be localized, where they were in the city.